

**D E K R E T**  
**Nr.7450, datë 5.1.1991**

**PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE PËR JASHTË SHTETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE"**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;  
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR  
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE  
TË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në dekretin nr.7393, datë 12.6.1990 "Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënie e vizave", neni 4 ndryhohet si vijon:

Vizat mundë të jenë individuale dhe kolektive. Si rregull, viza jepet për një udhëtim dhe për një periudhë deri në një vit. Për raste të veçanta ajo mund të jepet edhe për më shumë se një udhëtim.

Viza mund të zgjatet me kërkesën e shtetasit edhe nga përfaqësitë tona diplomatike e konsullore jashtë shtetit.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

- Në gërmën "a" hiqen fjalët: "ose e ka lënë apo i është hequr ajo".

- Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për shtetasit shqiptarë, të cilëve u është hequr shtetësia ose e kanë lënë atë, pasaporta mbetet e vlefshme deri në daljen e tyre nga territori i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR  
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE  
TË SHQIPËRISË

SEKRETAR  
**Sihat Tozaj**

KRYETAR  
**Ramiz Alia**